



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:220209

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855112

C.nr.1694/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses N. C. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Qëndresa Bytyqi Hoxha, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 682.00 euro, jashtë seance me datë 25.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses N. C. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses së lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.06.2021 e deri me datë 22.11.2022, respektivisht për 341 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 682.00.€ (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 16.10.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzet e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja N. C. nga Gjakova në këtë gjykatë me datë 16.10.2023, përmes të autorizuarit të saj Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se paditësja është e punësuar në shkollën “Mustafa Bakija” në Gjakovë, e që për periudhën prej datës 01.06.2021 e deri me datë 22.11.2022 ka vijuar në total 341 ditë të pranisë në punë. Meqenëse të njëjtës nuk i është kompensuar obligimi për ushqimin në punë nga e paditura, atëherë paditësja ka paraqitur padi duke kërkuar shumën prej 682.00 euro në emër të shpenzimeve të ushqimit, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Qëndresa Bytyqi Hoxha, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 03.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësja nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar

paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se dita e plotë e punës është 8 orë pune dhe nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë. Tutje ka cituar dispozitën e nenit 46 par.2 të KKAK-së ku shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, për çka ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në Kontratë sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjetet financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive për pagesën e shujtës. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Ka theksuar se ka indikacione që kemi të bëjmë me rast të gjykuar, ku ka kërkuar nga gjykata verifikimin e kësaj rrethane. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë dhe se në periudhën prej datës 01.06.2021 e deri me datë 22.11.2022 ka punuar gjithsej 341 ditë pune, fakt i vërtetuar përmes Vërtetimit për ditët e prezencës në punë i lëshuar nga shkolla e lartcekur me datë 10.10.2023. Gjykata provës së lartcekur ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e saj, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK-së, ku është përcaktuar se *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të*

te punësuarve për ushqim për t'a bërë kompensimin”, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.06.2021 deri me datë 22.11.2022, bëri përlllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë që për këtë periudhë kohore janë 341 ditë, i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 682.00 euro.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha pretendimet e përfaqësueses ligjore të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, të cilat i refuzoi për arsyet si në vijim:

Fillimisht, sa i përket pretendimit të të paditurës se rasti ka të bëjë me çështje të gjykuar, gjykata gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar kjo për faktin se pas shikimit të të gjitha çështjeve juridike kontestimore të iniciuara nga paditësja lidhur me kompensimin e ushqimit në punë, ka rezultuar se në këtë gjykatë lidhur me këtë kërkesë për paditësen nuk ka asnjë rast tjetër.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata analizoi edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes Vërtetimit të lëshuar nga shkollat përkatëse ku punon paditësja dhe të njëjtës i fali besimin pasi që është e hartuar në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që të i kompensohen shpenzimet e ushqimit për

periudhën kohore prej datës 01.06.2021 deri me datë 22.11.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me 16.10.2023, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej t'a përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e saj në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësja.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1694/23, datë 25.06.2024

G j y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.